



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI I MINISTRAVE**

**V E N D I M**

**Nr 493 Date 06.07. 2011**

**PER**

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NE VENDIMIN NR.929, DATE 17.11.2010, TE  
KESHILLIT TE MINISTRAVE "PER KRIJIMIN DHE PERDORIMIN E FONDIT TE  
VECANTE"**

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes, te nenit 18, te Ligjit nr. 8549, date 11.11.1999, "Statusi i nepunesit civil", te nenit 5/1, te ligjit 8487, date 13.5.1999, "Per kompetencat per caktimin e pagave te punes", te ndryshuar, te ligjit nr.9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar dhe ligjit nr.9936, date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", me propozim te Ministrit te Financave, Keshilli i Ministrave,

**V E N D O S I :**

1. Pika 7 dhe 8 te vendimit nr.929, date 17.11.2010, te Keshillit te Ministrave ndryshohen si me poshte vijon:

"7. Ne ndihma te menjehershme per raste fatkeqesish dhe raste te tjera, te cilat perballohen nga fondi faktik i vecante perfshihen pagesat per rastet e :

- vdekjes se punonjesit te institucionit. Pagesa i jepet familjes se punonjesit nga titullari i institucionit ne masen e nje page mujore por jo me pak se 50 000 leke.
- vdekjes se nje anetari te familjes se punonjesit (bashkeshorti/ja, prinderit apo femijet). Pagesa jepet nga titullari i institucionit deri ne 30 000 leke per cdo rast.
- semundjeve te renda te punonjesit, kur kerkohet nje nderhyrje kirurgjikale apo nje trajtim mjekesor i gjate. Pagesa jepet nga titullari i institucionit deri ne 50 000 leke per cdo rast.
- daljes se punonjesve ne pension pleqerie. Pagesa jepet nga titullari i institucionit deri ne masen e nje page mujore.

Edhe ne rastet kur sipas ligjeve te vecanta lindin te drejta specifike te dhenies se ndihmave te menjehershme, masa e ndihmes se dhene perballohet nga fondi i vecante, i perlllogaritur sipas pikes 1 te ketij vendimi. Ne keto raste specifike, masa e ndihmes jepet pas miratimit nga titullari i institucionit qendror perkates nepermjet nje udhezimi ne te cilin parashikohen rregullat dhe kriteret e perfitimit te ketyre ndihmave".

8. Ne veprimtari me karakter social apo kulturor qe perballohen nga fondi i vecante, perfshihen ato veprimtari te cilat organizohen vetem per punonjesit e institucionit, sikurse jane ato te organizuara per rastet e daljeve ne pension, te festimeve te fundvitit, dhe te tjera organizime te realizuara nga institucioni. Ne cdo rast, masa e shpenzimit qe mbulohet nga fondi i vecante per keto aktivitete, nuk duhet te kaloje vleren e 2500 (dy mije e peseqind) leke per punonjes.

Kur veprimtarite social-kulturore organizohen jashte qendres se punes, shpenzimet e transportit dhe akomodimit paguhen nga vete punonjesit”.

2. Ngarkohen njesite e qeverisjes se pergjithshme per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne ”Fletoren zyrtare”

**K R Y E M I N I S T R I**

**SALI BERISHA**